

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 nënparagrafi 8 dhe neni 20 paragrafi 1 nënparagrafi 11<sup>1</sup>të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 50 dhe nenin 50-a nga Ligji i njëjtë, në pajtim me nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 7 dhe neni 39 paragrafi 1 nënparagrafi 11 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Teksti i pastruar) nr.01-3732/1, datë 29.07.2019 dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr.02-4118/3 datë 09.10.2024., është përgatitur Tekst i pastruar i Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

Teksti i pastruar i Rregullores për mbrojtjen e të miturve përfshin: Rregulloren për mbrojtjen e të miturve ark.nr.01-5777/1 datë 21.11.2014 dhe Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mbrojtjen e të miturve ark.nr.01-4198/1 datë 09.10.2024.

## **RREGULLORE PËR MBROJTJEN E TË MITURVE (Tekst i pastruar)**

### **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Objekt i Rregullores**

Të gjithë ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele, gjegjësisht transmetuesit dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë - dhe persona fizikë (ndikues/vlogger/kreator) edhe persona juridikë, kanë detyrimin të mbrojnë të miturit nga përmbajtje - programe/video të krijuara nga përdoruesit/komunikimet komerciale audio dhe audiovizuele, që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin e tyre fizik, mendor ose moral, veçanërisht nga përmbajtje pornografike<sup>2</sup>, pornografi me fëmijë<sup>3</sup>ose dhunë e tepruar<sup>4</sup>.

---

<sup>1</sup>Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë: shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18).

<sup>2</sup>Pornografia, për qëllimet e Rregullores për mbrojtjen e të miturve, është tërësi ose pjesë e materialit audiovizual të shfaqur me qëllim bazë dhe funksion të përmbushjes së dëshirës seksuale, nëpërmjet përshkrimeve, skenave dhe/ose pamjeve të lakuriqësisë seksuale, marrëdhënieve seksuale, masturbimit dhe /ose stimulimit seksual, që nuk paraqesin element të domosdoshëm estetik, humanist apo informativ nga konteksti i përpunimit artistik ose të temës gazetareske të analizuar.

Përmbajtja me pornografi dhe dhunë e tepruar mund të transmetohet/përcillet vetëm në formë të koduar dhe përmbajtja pornografike me fëmijë është plotësisht e ndaluar.

Përmbajtje të tjera – programe/video të krijuara nga përdoruesit që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe/ose moral të të miturve duhet të shënohen paraprakisht. Përveç kësaj, transmetuesit duhet t'i emetojnë në kohë të përshtatshme gjatë ditë-natës.

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e kategorizimit të përmbajtjeve, periudhat e transmetimit të programeve audiovizuale, format e paralajmërimit akustik dhe vizual, shenjat vizuale, masat teknike që duhet të ndërmerren nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë për mbrojtjen e të miturve si dhe mënyrën e veprimit të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale.

## Neni 2 Fjalorth

Disa shprehje të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e mëposhtëm:

- **Persona të mitur** janë personat nën moshën 18 vjeç;
- **Përmbajtje të tjera – programet/videot e krijuara nga përdoruesit / komunikimet komerciale që mund të dëmtojnë të miturit** janë njësi audiovizuale ose pjesë përbërëse të tyre që përshkruajnë shkallë dhe intensitet të ndryshëm dhune, erotikë, sjellje seksuale të ndaluara me ligj, shprehje dhe gjeste të turpshme, sjellje të rrezikshme që është lehtë për t'u imituar, të dëmshme për shëndetin dhe të rrezikshëm për sigurinë e individit dhe komunitetit, si dhe sjellje fyese për dinjitetin njerëzor, përmbajtjen dhe komunikime komerciale për lojëra të veçanta të fatit, etj.;
- **Video e krijuar nga përdoruesi** është tërësi e pamjeve lëvizëse me ose pa zë, pavarësisht nga kohëzgjatja, që paraqet element të veçantë, të krijuar nga përdoruesi dhe vendosur në platformën për ndarjen e videos nga ai përdorues ose nga përdorues tjetër;
- **Dhuna** është çdo shfaqje e sjelljes agresive psikofizike, kërcënim ose qëllimi të realizuar, me ose pa armë, për të frikësuar, poshtëruar dhe/ose (vetë) lënduar një individ, grup ose komunitet. Në të njëjtën kohë, mund të bëhet fjalë për shfaqjen e dhunës që është kryer tashmë ose për qëllimin e kryerjes së dhunës, pavarësisht nëse ajo dhunë mund ose nuk mund të shkaktojë lëndim. Termi përfshin gjithashtu dhe çdo përshkrim të pasojave të dëmtimit fizik të ndonjë qenieje të gjallë (ose grupi qeniesh të gjalla), edhe pse akti i dhunës nuk përshkruhet;

---

<sup>3</sup> Pornografia me fëmijë nënkuptoni: "material pornografik që përshkruan vizualisht akte të qarta seksuale me të mitur ose person të rritur që duket si i mitur, ose tregon të mitur ose personin e rritur që duket si i mitur në pozicion seksual të qartë, ose pamje reale që tregojnë dukshëm akte seksuale me të mitur ose përshkruajnë të miturin ose personin e rritur që duket si i mitur në pozicion të qartë seksual" (neni 122 pika 24 e Kodit Penal).

<sup>4</sup> „Dhuna e tepruar paraqet shpërndarje e mesazheve tekstuale, verbale dhe vizuale që, në terma programorë të aksesueshëm për të miturit, lavdërojnë forma fizike, verbale ose psikologjike të sadizmit ose lloje të ngjashme të dhunës, që është një qëllim në vetvete dhe në asnjë mënyrë nuk mund të justifikohet as përmes kontekstit të zhanrit as përmes motiveve të veprimit dramatik të programit të shfaqur” (neni 50 paragrafi 2 i Ligjit për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale).

- **Erotika** është prezantimi i përshkrimeve, skenave dhe/ose pamjeve të lakuriqësisë seksuale, pavarësisht nga zhanri dhe funksionit programor i materialit audiovizual;
- **Periudhat kohore** janë terma të përcaktuara saktësisht të shërbimit programor radiodifuziv të planifikuar gjatë një ditë-natë, të përcaktuara për shfaqjen e materialit audiovizual të kategorizuar sipas grupmohave të pritshmërisë së publikut;
- **Konteksti programor** përfshin: zhanrin e programit; funksionin e programit (informativ, edukativ ose argëtues); grupi kryesor i synuar në publikun e mundshëm; formati në shërbimin programor; periudhën kohore e programit dhe renditja e programeve në skemën programore për shërbimet programore televizive; orari i programimit në katalog sipas kategorive për ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë; shkallën e dëmtimit që mund të shkaktojë ndonjë përmbajtje programore; numrin e pritur dhe përbërjen e publikut potencial dhe pritshmëritë e mundshme të publikut; shkallën në të cilën jepen detaje për përmbajtjen për të cilën është informuar publiku i mundshëm; efektet plotësuese që përmbajtja mund të shkaktojë tek shikuesit, si dhe mundësia e mospërfshirjes së detajeve shqetësuese me dhunë dhe përmbajtje erotike të përfshira në materialin audiovizual i planifikuar të shfaqet kur raportohet për tema me rëndësi për publikun. Aspektet e zbatueshme të kontekstit programor duhet të merren parasysh dhe gjatë organizimit të videove të krijuara nga përdoruesit.

#### Neni 2-a

### **Mbrojtja e të dhënave personale të të miturve**

Të dhënat personale të të miturve të mbledhura ose në mënyrë tjetër të krijuara ose të fituara nga ofruesit e shërbimeve mediatike, gjatë zbatimit të masave të kësaj Rregulloreje, nuk mund të përpunohen për qëllime komerciale, siç janë marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi dhe analiza ose reklamimi i sjelljes.

## **II. PËRMBAJTJE TJERA QË MUND TË DËMTOJNË TË MITURIT**

#### Neni 3

### **Dhuna**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale janë të detyruar të kenë parasysh se shfaqja e shpeshtë dhe e vazhdueshme e dhunës mund të ketë efekt negativ kumulativ mbi të miturit, që mund të shprehet duke ulur shkallën e ndjeshmërisë ndaj dhunës dhe duke zhvilluar një qëndrim se dhuna mund të paraqet mënyrë të pranueshme për zgjidhjen e problemeve.

Frika e shkaktuar nga përshkrimet, nga skenat dhe/ose pamjet e dhunës mund t'i shqetësojë shumë të miturit. Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale duhet gjithmonë me përgjegjësi të krijojnë ekuilibër ndërmjet - të drejtës së publikut për t'u informuar me kohë dhe saktë dhe - nevojën për mbrojtjen e të miturve.

Skenat me dhunë verbale ose fizike ose sjellje të tjera të rrezikshme që mund të imitohen lehtësisht nga të miturit dhe që mund të jenë të dëmshme ose të rrezikshme për ta, nuk duhet të shfaqen në përmbajtje që janë të destinuara kryesisht për të mitur.

#### Neni 4

### **Përdorimi i drogave, substancave psikoaktive, cigareve dhe alkoolit**

Përdorimi i drogave, substancave psikoaktive, cigareve, cigareve elektronike dhe mjeteve për mbushjen e tyre, si dhe alkooli, nuk duhet të shfaqet në përmbajtje audiovizuale që janë të destinuara kryesisht për personat e mitur.

Në përmbajtjet audiovizuale që nuk janë destinuar për të mitur ato nuk duhet të mbështesin, inkurajojnë, nxisin ose lavdërojnë përdorimin e drogave, substancave psikoaktive, cigareve, cigareve elektronike dhe mjeteve mbushëse, si dhe alkoolit, përveç rasteve kur kjo justifikohet nëpërmjet kontekstit të zhanrit ose përmes motiveve të veprimit dramatik në programin artistik.

#### Neni 5

### **Erotika**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale janë të detyruar të kenë parasysh se edhe pse në përmbajtjet audiovizuale deri në kufi të caktuar lejohet shfaqja e erotizmit, një përmbajtje e tilla gjithësesi mund të shkaktojë dëme për të miturit. Kjo është arsyeja pse kategorizimi i përmbajtje erotike duhet të bëhet në përputhje me përshkrimet e kategorive të programeve të përcaktuara në Rregullore.

Kur bashkëngjitet në programet e lajmeve dhe në programet informative përfshijnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që përmbajnë erotikë, vlerësimi i përshtatshmërisë së periudhës së prezantimit të tyre në shërbimet programore televizive duhet të bazohet mbi shkallën e qartësisë së detajeve të shfaqura.

#### Neni 6

### **Sjellja seksuale e ndaluar me ligj**

Përpunimi mediatik i temave që lidhen me pedofilinë, abuzimin seksual të të miturve dhe forma të tjera të sjelljes seksuale të ndaluara me ligj, mund të justifikohen vetëm për të drejtën e publikut për t'u informuar dhe për problematizimin e tyre më të gjerë shoqëror.

Trajtimi mediatik i temave lidhur me pedofilinë dhe forma të tjera të sjelljes seksuale të ndaluara me ligj, në lajme, programet informative, dokumentare apo programe të tjera, nuk duhet të përfshijë asnjë sugjerim ose nxitje të qëndrimi të padëshirueshëm shoqëror.

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale janë të detyruar që gjatë kategorizimit të programeve të kenë parasysh se përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet e përdhunimit dhe pasojat e përdhunimit mund të kenë veçanërisht pasoja të dëmshme mbi të miturit.

Planifikimi i transmetuesve televizivë nga radiodifuzerët për transmetimin e programeve, skenari i të cilëve trajton abuzim seksual të të miturve duhet të bazohet në faktin se të miturit mund të shqetësohen si rezultat i identifikimit të pritshëm me viktimën e paraqitur të aktit të dhunshëm.

Kur bashkëngjitet (fragmentet) në lajmet dhe programet informative përfshijnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që përmbajnë sjellje seksuale të ndaluara me ligj, vlerësimi i përshtatshmërisë së periudhës së prezantimit të tyre duhet të bazohet mbi shkallën e qartësisë së detajeve të treguara.

## Neni 7

### **Shprehje dhe gjeste të turpshme**

Përdorimi i shprehjeve dhe gjesteve të turpshme është i pranueshëm në lloje të caktuara programesh argëtuese, në programe artistike si element estetik ose në programe edukative dhe dokumentare që tematizojnë vepër arti të fjalës së turpshme (vulgare) dhe aspektet e tij të motivuara nga shoqëria.

Në programet e destinuara për të gjithë familjen, që transmetohen në shërbimet programore televizive në periudhën deri në orën 20:00 nuk lejohet përdorimi i tepruar i shprehjeve dhe gjesteve të turpshme.

## Neni 8

### **Forma sugjестive të sjelljes të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë**

Për mbrojtjen e të miturve, shfaqja e përmbajtjeve – programeve/videove/të krijuara nga përdoruesit/komunikimeve komerciale me përshkrime, skena dhe/ose pamje sjelljesh të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë, që mund të imitohen lehtësisht, duhet të justifikohet gjithmonë në kontekstin e duhur.

## Neni 9

### **Shfaqja e praktikave të okultizmit dhe pseudomjeksisë**

Përmbajtja që përshkruan praktika të okultizmit (çdo lloj parashikimi - palmistikë, hamendje, tarot, astrologji, spiritualizëm, etj) dhe pseudomjeksia duhet të shënohen si programe të kategorisë së pestë që nuk rekomandohen për publikun nën 18 vjeç, dhe transmetuesit mund t'i transmetojnë ekskluzivisht në periudhën nga 00:00 deri në 05:00.

Okultizmi dhe pseudomjeksia mund të paraqiten ekskluzivisht në kontekst programor jo të dyfishtë si temë argëtuese, informuese dhe/ose edukative, e analizuar në mënyrë humaniste dhe nuk mund nëpërmjet asnjë lloj ndërveprimi të këshillojë dhe/ose sugjerojë ndryshime në sjelljen personale dhe/ose sjelljes kolektive dhe të rrethanave të jetës, që kanë të bëjnë me shëndetin, financat, punën ose marrëdhëniet ndërpersonale.

Kufizimi i periudhës së transmetimit nuk vlen për përmbajtjen e shkurtër të horoskopit ditor, të klasifikuar si - program me funksion argëtues.

## Neni 10

### **Shfaqja e procedurave për hipnotizim**

Ndalohet prezantimi i materialit audiovizual që në tërësi ose në disa pjesë të tij, është e specializuar në procedurat e detajuara hipnotizuese.

Hipnoza mund të paraqitet ekskluzivisht e kontekstualizuar si temë argëtuese, informuese dhe/ose edukative, e analizuar në mënyrë humaniste.

Shërbimet programore televizive janë të detyruara që para fillimit dhe pas pushimit për reklama në programe të tilla, në ekran, dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë në vend të përshtatshëm në katalog, të publikojnë paralajmërim se programi përmban procedura për hipnotizim.

Neni 10-a  
**Përmbajtja me këshilla për lojëra të veçanta fati**

Emisionet e specializuara informative dhe revista sportive, si dhe video të krijuara nga përdoruesit, me këshilla për lojëra të veçanta fati (lojëra fati në kazino, lojëra fati në bastore, lojëra fati në klubet e lojërave të fatit)<sup>5</sup>si tërësi ose pjesë të tërësisë audiovizuale informative dhe/ ose me funksion mediatik që publikut drejtpërdrejtë i sugjeron mundësi për bast në lojëra të veçanta të fatit me rrezik financiar, transmetuesit mund t'i transmetojnë ekskluzivisht në periudhën prej orës 00:00 deri në orën 05:00, shënuar në mënyrë përkatëse me sinjalin paralajmërues për program të kategorisë së pestë.

Shënimi me sinjal paralajmërues për program të kategorisë së pestë është gjithashtu i detyrueshëm dhe për këtë lloj oferte programore tek ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë.

Neni 10-b  
**Komunikimet komerciale për lojëra të veçanta fati**

Komunikimet komerciale audiovizuale për lojëra të veçanta fati duhet qartë dhe dukshëm të shënohen me sinjalistikën paralajmëruese për kategorinë e pestë të programit, por mund të shfaqen gjatë gjithë programit të ditë-natës së transmetuesit, përveç në emisionet e programeve parësore me funksion informativ, argëtues dhe edukativ të destinuar për fëmijë.

Shënimi me sinjalistikën paralajmëruese për program të kategorisë së pestë gjithashtu është i detyrueshëm për komunikimet komerciale audiovizuale për lojërat e veçanta të fatit nga ofruesit e shërbimeve mediatike me kërkesë.

Neni 10-v  
**Formati i programit "realist".<sup>6</sup>**

Duke qenë se paraqet material të papërpunuar audiovizual me ndërhyrje editoriale minimale ose të maskuara me mjeshtëri, që në raste të caktuara është një hibrid i dokumentuar dhe i drejtuar, me motivin parësor regjistrimin e situatave në të cilat sjellja e pjesëmarrësve të rastësishëm ose të përzgjedhur është e paparashikueshme, përmbajtjet që i përkasin formatit "realist" programi duhet të karakterizohet me kujdes në përputhje me kontekstin programor, me kriteret e klasifikimit dhe me përshkrimet e kategorive të programit, veçanërisht nëse ato përbëhen nga përshkrime, skena dhe/ose pamje që përshkruajnë dhunë dhe erotikë.

---

<sup>5</sup>Sipas Ligjit për lojërat e fatit dhe për lojrat argëtuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/11, 51/11, 148/11, 74/12, 171/12, 27/14, 139/14, 61/15, 154/15, 23/16 dhe 178/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 251/22),

<sup>6</sup>Detajisht e përshkruar në pikën 16.11. të "Udhëzimit për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audiovizive dhe audio".

Neni 11  
**Epilepsi fotosensitive**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale janë të detyruar të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur shikuesit që vuajnë nga epilepsia fotosensitive.

Shërbimet programore televizive janë të detyruar që përpara fillimit dhe pas pushimeve për reklamim në programe të tilla, në ekran, dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë në një vend të përshtatshëm në katalog, të publikojnë paralajmërim se ka një dritë vezulluese në program. .

Neni 12  
**Lajme të simuluar**

Lajme të simuluar që janë pjesë e ndonjë programi argëtues, drame, dokumentari ose programi tjetër ose që transmetohet nga ofrues i shërbimit mediatik audiovizual për programet e tij nuk duhet të shfaqen në atë mënyrë që t'i shtyjë shikuesit të mendojnë se ajo që po shohin dhe dëgjojnë janë në të vërtetë lajme ose informacion për diçka që në të vërtetë ka ndodhur.

### III. KATEGORIZIMI I PROGRAMEVE DHE PERIUDHAT KOHORE

Neni 13  
**Programet që i nënshtrohen kategorizimit**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale janë të detyruar të kategorizojnë totalin e programit që transmetohet në shërbimet programore televizive ose ofrohet në katalogun e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, me përjashtim të lajmeve dhe programeve informative.

Neni 14  
**Kriteret për kategorizimin e programit**

Redaktori, në bazë të ndërgjegjësimit të tij e tij etik dhe përgjegjësinë editoriale, duhet me vëmendje të vlerësojë nëse në kontekstin konkret programor është i nevojshëm transmetimi i përmbajtjeve potencialisht të dëmshme për të miturit.

Gjatë rishikimit të përmbajtjes dhe gjatë kategorizimit të programeve, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale duhet të marrin parasysh kriteret e mëposhtme:

- numrin (përfaqësimin) dhe natyrën e përshkrimeve, skenave dhe/ose pamjeve me dhunë, erotizëm, sjellje seksuale të ndaluara me ligj, fjalim të turpshëm (vulgar), forma sugjестive të sjelljes që janë të lehta për t'u imituar dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë, sjellje fyese për dinjitetin njerëzor etj.;
- gjallëria dhe detajet me të cilat krijohet brutaliteti dhe/ose vulgariteti i dukshëm i përshkrimeve, skenave dhe/ose pamjeve;
- vlerësimi nëse përshkrimet, skenat dhe/ose skenat e dhunës, erotika, sjelljet seksuale të ndaluara me ligj, fjalimet e turpshme (vulgare), forma sugjестive të sjelljes që janë të lehta

për t'u imituar dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë, dhe sjelljet fyese për dinjitetin njerëzor, paraqesin elemente plotësuese në komplot dramatik, ose në kontekst të programit edukativ, dokumentar dhe/ose informues;

- nëse dhuna sugjerohet si mënyrë për të zgjidhur konfliktet;
- frekuenca dhe kohëzgjatja e planeve të mëdha dhe/ose përshkrimeve të detajuara verbale, grafike dhe/ose tekstuale, skenave dhe/ose pamjeve brutale dhe vulgare;
- efektet estetike shoqëruese: muzikë, maska, grim dhe elementë të tjerë grafikë, skenografikë dhe/ose elemente kostumesh që mund të shkaktojnë shqetësim ose të intensifikojnë ndjenjën e frikës dhe poshtërimit të dinjitetit njerëzor;
- psikologjia e personazheve dhe problematika e konkluzioneve kontraverze nga aspektet ekstroverte dhe introverte të personazheve dhe motivet e tyre për sjellje të dhunshme, që në mënyrë sugjestive të veprojnë ndaj të miturve;
- përshkrime, skena dhe/ose pamje të të miturve të shtyrë në situata brutale dhe/ose situata vulgare;
- trajtimi regjisorial dhe skenarist i dhunës dhe erotizmit: glorifikimi ose neutralizimi, i ndërtuar nëpërmjet përshkrimeve dhe nëpërmjet zhvillimit të skenave të tëra dhe/ose pamjeve brutale dhe vulgare;
- qasja e regjisorit dhe skenaristit ndaj temave kontraverze: nxitja e intolerancës racore, fetare, etnike, gjinore ose mbi çdo bazë tjetër, varësia nga droga, vetëvrasja, incesti, pedofilia, përdhunimi, krimet e gjakut dhe forma të ngjashme të kërcënimeve dhe/ose të pasojave nga tortura psiko-fizike.

#### Neni 15

### **Kategoritë e programeve**

Programet që i nënshtrohen kategorizimit klasifikohen në pesë kategoritë e mëposhtme:

- Kategoritë e parë - programe të destinuara për të gjithë publikun;
- Kategoritë e dytë - programe që nuk rekomandohen për fëmijët nën 8 vjeç, për ndjekjen e tyre është i domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari;
- Kategoritë e tretë - programe që nuk rekomandohen për fëmijët nën 12 vjeç, për ndjekjen e tyre është i domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari;
- Kategoritë e katërt - programe që nuk rekomandohen për fëmijët nën 16 vjeç, për ndjekjen e tyre është i domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari;
- Kategoritë e pestë - programe që nuk janë të përshtatshme për publikun nën 18 vjeç.

#### Neni 16

### **Periudhat kohore për kategoritë e programeve**

Në varësi të përbërjes së pritshme të publikut, kategoritë e programit mund të transmetohet në periudhat e mëposhtme kohore:

- Programet e kategorisë së parë dhe të dytë transmetohen gjatë gjithë ditës dhe natës;
- Kategoritë e tretë transmetohet në periudhën nga ora 20:00 deri në orën 05:00;
- Kategoritë e katërt transmetohet në periudhën nga ora 22:00 deri në orën 05:00;
- Kategoritë e pestë transmetohet në periudhën nga ora 00:00 deri në orën 05:00.



Neni 17  
**Përshkrim i kategorive të programit**

Kategoritë e programeve audiovizuale të përcaktuara në nenin 15 të Rregullores përcaktohen sipas përshkrimeve të mëposhtme:

- (1) **Kategoria e parë - programe destinuar për të gjithë publikun.** Programe që mund të transmetohen gjatë gjithë ditës-natës dhe që mund të ndiqen nga publiku më i gjerë, përfshirë fëmijët e moshës parashkollore. Përdorimi i të folurit të turpshëm (vulgar) duhet të reduktohet në nivelin më të ulët të mundshëm. Shfaqja e trupit zhveshur lejohet vetëm në pamje natyrale neutrale, jashtë çdo konteksti erotik. Nuk rekomandohet shfaqja e armëve të vërteta. Rekomandohet që përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet me akte dhune të kufizohen ekskluzivisht në kërcënime të nënvlerësuara pa asnjë shprehje të mizorisë verbale dhe/ose psiko-fizike në marrëdhëniet ndërpersonale. Ndalohet shfaqja e varësisë ndaj drogës, alkoolizmit dhe llojeve të ngjashme të sjelljeve devijuese. Skenat e frikshme duhet të dizajnohen sipas moshës së shikuesve më të rinj.
- (2) **Kategoria e dytë - programe që nuk rekomandohen për fëmijët nën 8 vjeç, për shikimin e tyre rekomandohet mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari.** Ato mund të transmetohen gjatë gjithë ditës-natës, me rekomandim që të ndiqen nën mbikëqyrjen e prindit ose kujdestarit. Është e mundur të trajtohen tema më serioze: sjellje devijante, dhunë familjare, racizëm dhe të ngjajshme, megjithatë programet në asnjë rast nuk duhet të nxisin ose përfshijnë në vetvete ndonjë afirmim të sjelljes devijuese ose sjellje fyese ndaj dinjitetit njerëzor. Nuk lejohet përdorimi i ekzagjeruar i fjalës së turpshme (vulgare). Lejohet pamje neutrale, natyrale e trupit të njeriut të zhveshur, por pa ndonjë kontekst seksual vulgar. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet me erotike duhet të jenë jashtëzakonisht të rralla dhe krejtësisht të nënvlerësuara, diskrete dhe pa aludime vulgare. Lejohet shfaqje e matur e dhunës, por pa detaje mizore, të justifikuara në kompletimin e skenarit, pa theksuar praninë e armës reale apo teknikave të rrezikshme për konfrontim ndërpersonal.
- (3) **Kategoria e tretë - programe që nuk rekomandohen për fëmijët nën 12 vjeç, për shikimin e tyre është i domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari.** Programe, skenari i të cilave përfshin përshkrime sistematike dhe të shpeshta, skena dhe/ose pamje të dhunës psiko-fizike, që mund të shqetësojnë të miturit. Përpunimi i temave serioze është i pranueshëm, por duhet të jetë i përshtatshëm për moshën e caktuar të publikut. Lejohet përdorimi i fjalës së turpshme, fyerjeve dhe brutalitetit, por duhet të reduktohet në masë të arsyeshme dhe të justifikohet me funksionin e nevojshëm në kontekstin dramatik ose informativ-dokumentar të programit. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet e dhunës dhe erotikës, dhe eventualisht ndërlidhja e mundshme midis këtyre dy faktorëve në zhvillimin e rrëfimit, nuk duhet të theksojë dëmtimet fizike dhe/ose pasojat psiko-fizike të lëndimeve, si dhe nuk duhet të përqendrohen në detaje fizike të turpshme. Nuk duhet t'i jipet rëndësi e theksuar armëve dhe teknikave për konfrontim ndërpersonal që janë lehtë për t'u imitua, me potencial të rrezikshëm për të ndikuar sugjestivisht mbi personat psikologjikisht më pak të qëndrueshme dhe mbi pjesën

emocionalisht të cënueshme të publikut. Përshkrimi i varësisë nga droga lejohet, megjithatë, pa përshkrim të detajuar të fazave të aktit që karakterizon personazhin dhe kompletuar në tërësinë e llojeve të ndryshme të programeve artistike, edukative, informative dhe/ose programit dokumentar. Njoftimet për programe të tilla nuk duhet të përbëhen nga përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të shqetësojnë të miturit.

(4) **Kategoria e katërt - programet që nuk rekomandohen për fëmijët nën 16 vjeç, për shikimin e tyre rekomandohet mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari.** Programe, skenari i të cilave përfshin përshkrime sistematike dhe të shpeshta, skena dhe/ose pamje të dhunës psiko-fizike, që mund të shqetësojnë të miturit. Nuk ka kufizime të temave. Lejohet përdorimi i shpeshtë i fjalës së turpshme, megjithatë është shumë vështirë të pranohet përdorimi i tepërt i shprehjeve jashtëzakonisht vulgare. Shfaqja e erotikës dhe marrëdhënieve seksuale lejohet, por pa detaje të qarta pornografike. Është i nevojshëm me kujdes të mendohet konteksti për shprehjet verbale dhe gjestike që kanë aludim të fortë seksual dhe mund të ofendojnë dinjitetin njerëzor. Përshkrimi i varësisë nga droga lejohet vetëm pa përshkrim të detajuar të fazave të aktit të përdorimit (abuzimit) të drogës, i balancuar me treguesin e pasojave dhe në funksion që karakterizon personazhet, kompletuar në tërësi të llojeve të ndryshmeve të programeve artistike, edukative, informative dhe/ose dokumentare. Janë të pranueshme përshkrimet, skenat dhe/ose pamje të dhunës dhe pasojat e dhunës, por jo përshkrime të sadizmit, ose çdo shprehje tjetër çnjerëzore dhe mizori ndaj njerëzve dhe kafshëve. Njoftimet për programe të tilla nuk duhet të përbëhen nga përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të shqetësojnë të miturit.

(5) **Kategoria e pestë - programe që nuk janë të përshtatshme për publikun nën 18 vjeç.** Tolerohen përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet e dhunës dhe pasojat e dhunës, si dhe përshkrimet e marrëdhënieve erotike. Respektohet e drejta autonome dhe vetëdija e personit të rritur për të vendosur kur zgjedh llojin dhe kategorinë e programit që dëshiron të shikojë. Transmetimi i pornografisë dhe sadizmit është i ndaluar dhe në asnjë rast nuk duhet të lidhet me këtë kategori programesh. Në këtë kategori programesh nuk ka kufizime në lidhje me temat, por kufizimet janë në lidhje me mënyrën e përpunimit të tyre.

#### Neni 18

#### **Vendosja e programeve që mund t'i dëmtojnë të miturit në skemën programore**

Gjatë planifikimit të transmetimit të programeve që mund të kenë efekt të dëmshëm në zhvillimin e të miturve, transmetuesit televizivë janë të detyruar të kenë parasysh kriteret e mëposhtme:

- natyra e përmbajtjes që mund të ketë efekt të dëmshëm për të miturit;
- funksionin mediatic dhe zhanrin e programit konkret;
- numrin dhe moshën e të miturve që mund të ndjekin programin, duke marrë parasysh ditët e javës, fundjavat dhe festat;
- pritshmëritë e mundshme të publikut në lidhje me përmbajtjen e programit në kohë të caktuar të ditës ose në ditë të caktuar.

## **IV.PARALAJMËRIM AKUSTIK DHE SHENJAT VIZUALE – SINJALIZIMI PARALAJMËRUES**

### **Neni 19**

#### **Përmbajtja në të cilën aplikohen sinjalet paralajmëruese**

Sinjali paralajmërues detyrimisht aplikohet para fillimit dhe gjatë transmetimit të programeve të shërbimeve programore televizive dhe në vend të përshtatshëm pranë programeve/videove të krijuara nga përdoruesit të pranishëm në katalogët e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, përkatësisht:

- në të gjitha llojet e programeve artistike, dhe
- në ato lloje programesh/video të krijuara nga përdorues me funksion informues, edukativ ose argëtues që, në tërësi ose nëpërmjet pjesëve të tyre, mund të kenë efekt të dëmshëm për të miturit.

Shërbimet Mediatike Audiovizuale me kërkesë duhet të tregojnë përmbajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni dhe gjatë kohës së shfaqjes së tyre, në përputhje me kushtet teknike të platformave për ndarjen e videove/rrjeteve sociale.

### **Neni 20**

#### **Mënyra e aplikimit të sinjalit paralajmërues**

Para fillimit të programeve televizive të parashikuara nga neni 19 i Rregullores, detyrimisht transmetohet sinjali paralajmërues që korrespondon me kategorinë e programit, që është kombinim i shenjës vizuale, tekstit, verbal dhe akustik, që zgjat së paku 10 sekonda dhe mbulon së paku 1/4 të pjesës së dukshme të ekranit.

Gjatë programeve televizive të parashikuara nga neni 19 i Rregullores, në vazhdimësi transmetohet vetëm shenja vizuale e sinjalit paralajmërues, e cila aplikohet me përmasa 1/32 në këndin e pjesës së dukshme të ekranit. Përrjashtim bëjnë shenjat vizuale për programet televizive me procedura hipnotizuese dhe dritë vezulluese, të cilat aplikohen në ekran pas çdo pushimi reklamash.







Në katalogët e shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, në vendin e duhur pranë programeve/videove të parashikuara në nenin 19 të Rregullores, detyrimisht aplikohet vetëm shenja vizuale që i përgjigjet kategorisë së programit dhe gjatë kohës së prezantimit të tyre shënohen me shenjë vizuale, verbalisht ose ndonjë mënyrë të përshtatshme në varësi të kushteve teknike të platformave për ndarjen e videove/rrjeteve sociale.





Paralajmërim i duhur duhet të lexohet dhe para fillimit të radioprogramit, sipas kontekstit programor dhe kriterëve të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, është potencialisht i dëmshëm për publikun e mitur.

Neni 21

**Pamja dhe përmbajtja e sinjalistikës paralajmëruese**

Sinjalistika paralajmëruese që aplikohet para, deri ose gjatë programeve nga ofruesit e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele duket kështu:

<b>Shenja vizuale</b>	<b>Sinjalet paralajmëruese</b>
	 <p><b>цела публика</b> Programe të kategorisë së parë destinuara për të gjithë publikun.</p>
	 <p><b>родителски надзор</b> Programet e kategorisë së dytë që nuk rekomandohen për fëmijët nën 8 vjeç . Kërkohet mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari.</p>
	 <p>Programet e kategorisë së tretë që nuk rekomandohet për fëmijët nën 12 vjeç. Kërkohet mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari.</p>

	 <p>Programet e kategorisë së katërt që nuk rekomandohet për fëmijët nën 16 vjeç. Kërkohe mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari.</p>
	 <p>Programet e kategorisë së pestë që nuk janë të përshtatshme për publikun nën 18 vjeç.</p>
<p>Program me procedura hipnotizuese</p>	<p><b>Paralajmërim:</b> Programi përmban procedura hipnotizuese</p>
<p>Program me dritë ndezëse</p>	<p><b>Paralajmërim:</b> Programi përmban dritë ndezëse që mund të dëmtojë shikuesit që vuajnë nga epilepsia fotosensitive</p>

#### Neni 22

#### Njoftimet për programet

Njoftimet (deklaratat promovuese) për programet e transmetuesve nuk duhet të përmbajnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të dëmtojnë personat e mitur.

Njoftimet nga paragrafi 1 i këtij neni deturimisht duhet të shënohen me shenjën vizuale që sinjalizon kategorinë e programit që paralajmërohet.

Njoftimet për programet e kategorisë së pestë nuk duhet të transmetohen para orës 22:00.

### V. PËRMBAJTJA NË LAJME DHE PROGRAMET INFORMATIVE

#### Neni 23

#### Procedura editoriale për domosdoshmërinë e detajeve

Kur lajmet dhe programet informative përfshijnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të ndikojnë negativisht tek të miturit, arsyetimi për shfaqjen e tyre duhet të bazohet mbi gjykim të përgjegjshëm editorial për domosdoshmërinë e detajeve në material të tillë.

Publikimi i shtojcase në shërbimet e programeve televizive që ndërmjetësojnë përshkrime, skena dhe/ose pamje të dhunës, materiale audiovizuele që mund të ofendojnë ose degradojnë dinjitetin njerëzor, shtojca të tjera përmbajtja e të cilave mund seriozisht të rrezikojë zhvillimin fizik, mendor dhe/ose moral të të miturve, duhet të jetë në periudhë kohore të skemës programore kur pritet që të miturit nuk e ndjekin programin.

Përgjegjësia profesionale e gazetarit nënkupton gjithashtu se viktimat e dhunës duhet të trajtohen me respekt maksimal, dhe për shkak të mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, trupi i tyre nuk duhet të shfaqet në kuadër me ekran të gjerë, përveç në raste të jashtëzakonshme kur kjo është e pashmangshme për shkak të integritetit të materialit informativ.

Gjatë publikimit të përshkrimeve, skenave dhe/ose pamjeve që shfrytëzohen si prova gjyqësore, përgjegjësia mediatike e detyron redaktorin e programit me kujdes të vlerësojë nëse është e nevojshme që kapacite informues i materiali të tillë të përfshihet në tërësinë e programit të shfaqur.

#### Neni 24

##### **Koment paralajmërues**

Nëse shtojcat(fragmented) ose pjesët përbërëse të shtojcave në lajme dhe në programet informative përfshijnë përmbajtje që mund të shqetësojnë të miturit, transmetuesit televizivë janë të detyruar t'i paraqesin me koment paralajmërues nga drejtuesi.

Kjo qasje, në asnjë rast, nuk nënkupton kufizim të temave dhe ngjarjeve për të cilat duhet të raportohet, por transmetimi duhet të pasohet nga komente gazetareske dhe/ose koment nga ekspert që do të mundësojnë objektivitetin e këndvështrimit informativ.

#### Neni 25

##### **Autorë të mitur ose viktimat të veprave penale**

Nëse në lajme raportohet për të mitur që janë autorë, dëshmitarë ose viktimat të dhunës seksuale ose krimeve të tjera, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm që të mos publikojnë përshkrime, detaje, pamje ose ndonjë informacion që mund në mënyrë direkte ose indirekte të tregojnë identitetin e tyre.

## **VI . DETYRIME TË VEÇANTA PËR SHËRBIMET MEDIATIKE AUDIOVIZUELE ME KËRKESË**

#### Neni 26

##### **Masat teknike për mbrojtjen e të miturve**

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës janë të detyruar të ofrojnë masa teknike që do të paralajmërojnë qasjen e të miturve në përmbajtje që mund t'i dëmtojë ata.

Masat teknike nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jenë:

- kodet për identifik personal (kodet PIN) me të cilat ofruesi i shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë mund të kontrollojë moshën e shfrytëzuesit para se t'i japë qasje në përmbajtjet e koduara të kategorizuara dhe të shënuara në pajtim me dispozitat e Rregullores;
- filtrimin e përmbajtjeve të kategorizuara nga ofruesi i shërbimit mediatik audiovizuel me kërkesë dhe të shënuara në pajtim me dispozitat e Rregullores;

- aplikimi i sistemeve të pavarura të filtrimit që analizojnë programin, njohin dhe përjashtojnë përmbajtje të dëmshme bazuar në kategoritë e përcaktuara nga prindi/kujdestari;
- aplikimi i softuerëve të tjera që prindërve/kujdestarëve u mundëson të bllokojnë qasjen e të miturve në përmbajtje që mund t'i dëmtojnë.

#### Neni 27

### **Njoftimet promovuese për përmbajtjen**

Njoftimet promovuese për përmbajtjen e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës nuk duhet të përmbajnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të dëmtojnë personat e mitur.

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, janë të detyruar t'i shënojnë njoftimet promovuese për përmbajtjet që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e të miturve me një shenjë vizuale, verbalisht ose në mënyrë tjetër të përshtatshme në varësi të kushteve teknike të platformave/rrjeteve sociale për ndarjen e videove..

Informacioni në lidhje me kategorinë e pestë të programeve/videove mund të paraqitet vetëm si pjesë e shërbimit të disponueshëm për pagesë, pavarësisht nëse kemi të bëjmë me shërbim me parapagesë (abonim) ose shërbim me pagesë për shikim.

## **VII. Dispozitat përfundimtare**

#### Neni 28

(neni 28 i Rregullores për mbrojtjen e të miturve  
"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.172/14)

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon së vlefshmi Rregullorja për mbrojtjen e publikut të mitur nga programet që mund të dëmtojnë zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe moral ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr 21/07).

#### Neni 29

(neni 29 i Rregullores për mbrojtjen e të miturve  
"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.172/14)

Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, duhet të harmonizojnë punën e tyre me dispozitat e kësaj Rregulloreje në afat prej 2 (dy) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi.

### Neni 30

(neni 30 i Rregullores për mbrojtjen e të miturve  
„Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.172/14)

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

### Neni 31

(neni 18 i Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mbrojtjen e të miturve  
"Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.213/24)

Kjo Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për mbrojtjen e të miturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.172/14 ), hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI. d.v.**